VENDIM
Nr. 289, datë 21.5.2018

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "NDËRTIMI I RI I SHKOLLËS TIP 1 + TIP 4, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR. 9, SHESHI 9/1", NË BASHKINË TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 109/2017, "Për buxhetin e vitit 2018", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtimi i ri i shkollës tip 1 + tip 4, në Njësinë Administrative nr. 9, sheshi 9/1", në Bashkinë Tiranë.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Tiranë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, me një vlerë të përgjithshme prej 46 741 296 (dyzet e gjashtë milionë e shtatëqind e dyzet e një mijë e dyqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekësh.

4. Pronarët e përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Tiranë.

5. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

6. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

7. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 46 741 296 (dyzet e gjashtë milionë e shtatëqind e dyzet e një mijë e dyqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekësh, të përballohet nga buxheti i Bashkisë Tiranë.

8. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2018, i miratuar për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

9. Shpronësimi të fillojë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

10. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Tabela nr. 1

LISTA E PASURIVE PRIVATE
ZËRI KADASTRAL AKTIVITET PRIVAT, SHTËPI BANIMI ETJ., QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "NDËRTIM I RI I SHKOLLËS TIP 1 + TIP 4 NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR. 9, SHESHI 9/1" ME ZHVILLUES BASHKIA TIRANË

Nr.	**ZK**	**Nr. i pasurisë**	**Lloji i pasurisë**	**Adresa**	**Pronari**	**Sipërfaqe truall e prekur**	**Sipërfaqe objekti e prekur**	**Çmimi i truallit, lekë/m²**	**Çmimi i objektit lekë/m²**	**Vlera e truallit, lekë**	**Vlera e objektit, lekë**	**Vlera e truallit dhe e objektit**	**Shënime**
1	8330	4/223	Truall		Zoje Boka	225		34,068		7,665,300		7,665,300	
2	8330	4/224	Truall		Zoje Boka	1147		34,068		39,075,996		39,075,996	
								VLERA TOTALE E SHPRONËSIMIT				**46,741,296**	